



SHPOPULLIMI I SHQIPËRISË DHE EFEKTET SOCIO- EKONOMIKE

28 Qershor 2024

THE ALBANIAN POLICY CENTER

Autorë: Prof Assc. Ines Nurja (Heba), Dr. Gent Kaprata dhe Xhonatan Pano

Hyrje

Shpopullimi është plaga më e madhe që kalon Shqipëria në vitet që pas rënies së komunizmit në vitin 1990. Pas vitit 1990 vendi ka përjetuar ndryshime të thella demografike dhe territoriale gjatë periudhës së tranzicionit. Përveç humbjes së popullsisë, Shqipëria po përballet edhe me plakjen e saj. Në janar të vitit 2023, mosha mediane e popullsisë ishte 38.2 vjeç, një tregues i qartë i një trendi rritës së moshimit. Kombet e Bashkuara paralajmërojnë se, nëse kjo tendencë vazhdon, deri në fund të shekullit, popullsia totale e Shqipërisë mund të bjerë nën 1 milion banorë, duke pasur kryesisht një popullsi të moshuar, me lindshmëri negative në krahasim me vdekshmërinë.

Këto ndryshime demografike kanë ndikuar në mënyra të ndryshme në strukturën dhe dinamikën e popullsisë në vend. Së pari, urbanizimi intensiv ka krijuar një përqendrim të madh të popullsisë në rajonin Tiranë-Durrës, duke rezultuar në mbipopullim të këtij rajoni dhe shpopullim të zonave të tjera rurale dhe periferike. Kjo ka sjellë ndryshime të mëdha në strukturën demografike dhe territoriale të vendit, me pasoja të ndjeshme sociale dhe ekonomike.

Në Shqipëri, mungesa e shifrave të sakta të regjistrimit të popullsisë ka krijuar një re pasigurie, duke ndikuar veçanërisht në fusha si planifikimi i buxhetit dhe menaxhimi i fuqisë punëtore. Popullsia e Shqipërisë është një mister i mbështjellë në një enigmë, ku askush nuk është plotësisht i sigurt se sa shqiptarë ende jetojnë e veprojnë brenda territorit. Kjo paqartësi gjithashtu ngre shqetësime të vlefshme në lidhje me besueshmërinë e rezultateve të censusit të fundit të qeverisë, i cili pritet të bëhet publik së shpejti dhe dyshimin për shpërndarje të gabuar të burimeve.

Për këtë arsye, Albanian Policy Center kreu një punë kërkimore e analitike, bazuar te të dhënat e EUROSTAT dhe raportet e Parlamentit dhe Qeverisë Britanike, për të bërë një përafrim të shqiptarëve të larguar në këto vite dhe të atyre që aktualisht janë ende në vend. Të dhëna të tilla nuk janë vetëm një kërkesë statistikore, por një katalizator për vendimmarrje të informuar dhe zhvillim të qëndrueshëm.

Albanian Policy Center organizoi gjithashtu një Tryezë Kombëtare për shpopullimin, efektet e tij dhe rrugëzgjdhjet. Tryeza ofroi një platformë për ekspertët e fushave të ndryshme në ekonomi, shëndetësi, arsim etj., të cilët diskutuan shkaqet, efektet në shoqërinë shqiptare dhe ofruan propozime e strategji të ndryshme për të trajtuar këtë krizë. U trajtuan politikatat dhe iniciativat që mund të ndihmojnë në përmirësimin e kushteve ekonomike, rritjen e cilësisë së jetesës, dhe krijimin e mundësive për të rinjtë për të ndërtuar një të ardhme në vendin e tyre. Qëllimi ynë ishte nisja e diskutimit për një plan veprimi konkret që mund të ndihmojë në ndalimin e shpopullimit dhe të kontribuojë në një Shqipëri më të fortë dhe të begatë.

Temat kryesore që u trajtuan në Tryezën Kombëtare janë:

1. Dinamikat demografike:

- Prezantimi i situatës aktuale demografike në Shqipëri
- Analizë e trendeve të popullsisë dhe ndikimit të tyre

2. Edukimi:

- Ndikimi i rënies së popullsisë në sistemin arsimor
- Strategjitë për të rritur numrin e nxënësve dhe cilësinë e arsimit

3. Ekonomia:

- Efektet e krizës së shpopullimit në ekonominë kombëtare.
- Politikatat ekonomike për të përballuar krizën
- Stabiliteti Financiar
- Analizë e ndikimit në bizneset dhe kursimet e konsumatorëve

4. Shëndetësia:

- Ndikimi i krizës së shpopullimit në sistemin shëndetësor
- Masat për të siguruar shërbime shëndetësore të qëndrueshme dhe cilësore

5. Politika Sociale:

- Ndikimi i krizës së popullsisë në politikatat sociale

- Strategjitë për të përmirësuar mirëqenien e qytetarëve

6. Industria dhe Teknologjia:

- Ndikimi i shpopullimit në sektorin industrial dhe teknologjik
- Strategjitë për të tërhequr investime dhe për të nxitur inovacionin

Metodologjia:

Diskutimet u zhvilluan sipas temave të renditura më sipër. Pati një debat të hapur interaktiv me të gjithë pjesëmarrësit të cilët ndanë pikëpamjet dhe idetë e tyre dhe rekomandimet specifike për avancimin e objektivave të konferencës dhe agjendës së APC.

Pjesëmarrësit:

Tryeza e diskutimit e organizuar nga Albanian Policy Center mbledhi një grup të ndryshëm ekspertësh, duke përfshirë akademikë, politologë, politikanë, drejtues të industrisë, përfaqësues të OJQ-ve, drejtues të komunitetit, profesionistë të medias, anëtarë të diasporës, ekonomistë dhe përfaqësues të rinjsh. Këta profesionistë nga fusha të ndryshme diskutuan çështjen urgjente të krizës së shpopullimit në Shqipëri si dhe pasojat që ajo ka në ekonomi, arsim, shëndetësi, bujqësi dhe familje.

Disa nga të dhënat shqetësuese më të rëndësishme që dolën gjatë punës kërkimore bazuar në shifrat e EUROSTAT janë:

- **478,245 të larguar me dokumenta të rregullta**
- **191,670 shqiptarë nga viti 2014-2023 kane kërkuar azil** në vendet e BE-së
- **311,650 individë qëndrojnë në mënyrë të paligjshme** në vendet e BE-së
- Janë **12,301 shqiptarë të mbërritur në Mbretërinë e Bashkuar nëpërmjet anijeve të vogla vetëm në vitin 2022**, sipas një raporti të vitit 2023 të Parlamentit Britanik. Në vitin 2020, një vit pandemie, 50 shqiptarë mbërritën me varka të vogla, ndërsa vitin pasardhës ishin 800.
- Në vitin 2019, Ministria e Brendshme e Mbretërisë së Bashkuar thoshte se **ka dy herë më shumë shqiptarë që hyjnë ilegalisht në vend përmes porteve të saj se çdo kombësi tjetër**. Një raport i vitit 2017, përmend se “shqiptarët kapen duke hyrë ilegalisht në Mbretërinë e Bashkuar më shumë se çdo kombësi tjetër”.

Shpopullimi dhe Urbanizimi në Shqipëri

Gjatë tranzicionit, Shqipëria përjetoi një urbanizim të gjerë, duke ndikuar në uljen e popullsisë dhe ndryshimin e modelit demografik e territorial. Nga viti 1989 deri në 2023, popullsia shqiptare brenda vendit ka pësuar një rënie të padiskutueshme. Ky shpopullim u shkaktua nga emigracioni i lartë dhe ulja e rritjes natyrore të popullsisë. Në të njëjtën kohë, migracioni i brendshëm ndryshoi strukturën urbane, duke krijuar një model të ri territorial me tre komponentë kryesorë:

- Rajoni i mbipopulluar Tiranë-Durrës: Përfshin 9% të territorit dhe 43% të popullsisë.
- Rajoni i balancuar Fier-Vlorë: Mbuluar 16% të territorit dhe 17% të popullsisë.
- Rajoni i shpopulluar: Tetë qarqe të tjera që përbëjnë 75% të territorit dhe 40% të popullsisë.

Ky model ka sjellë cilësi të dobët të jetesës urbane, degradim të tokës dhe deformime të strukturës urbano-hapësinore,

Ndikimet Sociale dhe Ekonomike

Modeli i urbanizimit dhe ndërtimtaria informale kanë thelluar ndarjen shoqërore midis qytetarëve para dhe pas vitit 1990, dëmtuar marrëdhëniet komunitare dhe homogjenitetin kulturor. Emigracioni ka shkëputur rrënjët kulturore të familjeve, duke krijuar kontradikta të forta midis brezave dhe duke prishur kohezionin social.

Ekonomia shqiptare mbështetet kryesisht te konsumi i mallrave të importit dhe ndërtimtaria, e financuar nga remitancat. **Sektori i prodhimit përbën vetëm 6% të ekonomisë, krahasuar me 13-24% në vendet e tjera të rajonit.** Modeli aktual ekonomik pamundëson zhvillimin e prodhimit, duke mbajtur Shqipërinë në një ekonomi të bazuar te konsumi. Ky model dëmton edhe ekonominë bujqësore, duke larguar punonjësit nga zonat rurale dhe zvogëluar fondin e tokës bujqësore.

Nevoja për një Model të Ri Territorial

Shqipëria ka domosdoshmëri për një model të ri territorial, të Rajoneve Policentrike Urbane, për të balancuar shpërndarjen demografike, minimizuar problemet urbane dhe territoriale dhe për të synuar integrimin në BE. Ky model kërkon një qasje anti-etatiste, duke e decentralizuar qeverisjen dhe përfshirë qytetarët në proceset planifikuese.

Reformat e Nevojshme

Rekomandohet një rikonceptim i legjislacionit për:

Legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtesave informale: Legalizimi i ndërtesave, kthimi i pronës te pronari legjitim i tokës dhe rregullimi i marrëdhënieve pronësore.

Planifikimin dhe zhvillimin territorial: Legjislacioni të mbështetet në parimet anti-etatiste dhe qasjet e BE-së, duke siguruar autonomi lokale dhe përfshirjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Reforma administrativo-territoriale: Ndarja e qeverisjes në tre nivele (kombëtar, rajonal dhe vendor) me autonomi të plotë dhe bashkërendim mes tyre. Kjo reformë do të krijonte një marrëdhënie të qartë dhe të ngushtë midis qytetarëve dhe qeverisjes.

Në përfundim, Shqipëria ka nevojë për një qasje të decentralizuar dhe gjithëpërfshirëse të qeverisjes për të krijuar një model të qëndrueshëm territorial, ekonomik dhe social.

Gjendja ekonomike e Shqiptarëve – një shtysë e rëndësishme në marrjen e vendimit për t’u larguar nga vendi

Një nga arsytet që i shtyn shqiptarët të largohen nga vendi është situata e vështirë ekonomike. Në kushtet e rritjes së vazhdueshme të çmimeve, dhe një ekonomie informale e ndikuar sipas raporteve ndërkombëtare në një masë të konsiderueshme nga pastrimi i parave, nga korrupsioni dhe tregtia e artikujve të paligjshëm, standardet që shqiptarët duhet të përballojnë për të jetuar janë shumë të larta në krahasim me të ardhurat e bazuara pothuajse plotësisht në paga të vogla, dhe transfertat sociale të pakta në numër dhe të papërfillshme në vlerë.

Të dhënat e INSTAT tregojnë se varfëria në Shqipëri është në rritje, dhe e shoqëruar edhe me privim material tregon për kushte të nivelit të jetesës edhe më të rënda sesa paraqet vlera monetare.

Treguesit e pagave tregojnë për një nivel mesatar, i cili është më i ulëti në rajon. Duhet të merret parasysh, gjithashtu, se gati gjysma e punonjësve janë punonjës në bujqësi, ku të ardhurat janë në bazë të shitjeve të produkteve të prodhuara në fermën e tyre (sipas Ligjit 7501), apo punonjës pa pagesë në biznesin e familjes.

Tabela 1: Të punësuar sipas statusit të punësimit, 2022

Të punësuar me pagë	49,1%
Të vetëpunësuar me të punësuar kundrejt një page	4,1%
Të vetëpunësuar pa të punësuar kundrejt një page	26,5%
Punëtorë pa pagesë në biznesin familjar	20,3%

Burimi: INSTAT, Anketa e Forcave të Punës

Për më tepër, buxheti mesatar që një familje me 4 persona shpenzon në muaj (sipas të dhënave të INSTAT referuar Anketës së Buxhetit të Familjes 2022) është 88,367 Lekë. Kjo shifër referuar shpenzimeve të ekuivalentuara për frymë sipas shkallës OECD (sipas të cilës shpenzimi për konsum familjar pjesëtohet me 2.1) do të thotë që konsumi mesatar për anëtarët e familjes është rreth 42 mijë lekë në muaj¹.

Tabela 2: Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë sipas aktiviteteve ekonomike (në lekë), 2022

Gjithsej	61,898
Bujqësi*	40,531
Industri	53,645
Ndërtimi	48,820
Shërbime të Tregut	86,102
Shërbime jo të Tregut	67,987

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kontribuuesit në Sigurime Shoqërore.

*Pagat e bujqësisë i referohen vetëm fermerëve - kontribuues me pagë në sektorin e Bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit - me pagë të deklaruar nga fermat/ndërmarrjet bujqësore të regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

¹ Shkalla e modifikuar nga OECD llogarit të ardhurat ekuivalente për anëtar të familjes sipas mënyrës së mëposhtme: çdo anëtar i familjes i jepet fillimisht një vlerë ekuivalente: 1,0 për të rriturin e parë; 0,5 për personin e dytë dhe secilin pasues të moshës 14 vjeç e lart; 0.3 për çdo fëmijë të moshës nën 14 vjeç.

Tabela 3. Masa e pensionit mesatar mujor për pensionet e qytetit dhe të fshatit sipas llojit të pensionit, 2022

	numër	vlerë (lekë)		numër	vlerë (lekë)
Pensione Qyteti	585,809		Pensione Fshati	101,114	
Pensione pleqërie	481,420	17,258	Pensione pleqërie	91,316	10,349
Pensione invaliditeti	61,348	15,064	Pensione invaliditeti	5,819	8,280
Pensione familjare	43,041	7,460	Pensione familjare	3,979	2,237

Burimi: INSTAT, Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Të gjitha shifrat e mësipërme tregojnë për të ardhura të pamjaftueshme për të përballuar një jetesë të denjë dhe të ekuilibruar. Nga ana tjetër, më specifikisht lidhur me të dhënat e varfërisë ne i referohemi Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës që nxjerr treguesit e varfërisë dhe pabarazisë.

Sipas kësaj ankete, të ardhurat mesatare mujore për frymë të ekuivalentuara janë 35,725 Lekë në muaj. Kjo shifër është e nënvlerësuar si rezultat i vështirësive që hasen në mbledhjen e informacionit si rrjedhim i sensitivitetit që paraqet deklarimi i të ardhurave në Shqipëri (duke mos përfshirë sidomos shtresën me të ardhura më të larta të popullsisë), gjë që është e dukshme edhe nga niveli i shpenzimeve mujore për frymë të ekuivalentuara, të nxjerra nga Anketa e Buxhetit.

Nëse do të arrinim të kishim nivelin e vërtetë të të ardhurave në Shqipëri, shkalla e varfërisë sipas metodologjisë së rrezikut për të qenë i varfër do të ishte edhe më e lartë.

Treguesit kryesore që llogarit kjo anketë janë:

1. Niveli i Rrezikut për të qenë i varfër tregon përqindjen e personave që jetojnë në familje ku të ardhurat e disponueshme të ekuivalentuara janë nën kufirin e rrezikut për të qenë i varfër. **Kufiri i rrezikut për të qenë i varfër për një person** në vitin 2022 është vlerësuar me 225,931 lekë, ndërsa është 576.316 numri i individëve që jetojnë nën kufirin e rrezikut për të qenë të varfër.

Kjo situatë është edhe më alarmuese nëse marrim parasysh të dhënat mbi asistencën sociale, të quajtur Ndhimë Ekonomike që i jepet familjeve pa të ardhura, e cila në vitin 2022 referuar familjeve me katër persona ishte 5,710 Lekë në muaj, ndërsa numri total i familjeve që e marrin këtë ndihmë është 57,160 familje, pra rreth 10 herë më i vogël se numri i të varfërve nga anketa.

2. Privimi Material, tregon nivelin e jetesës së popullsisë nga këndvështrimi i privimit material. Ky tregues është vlerësuar 33,2% në vitin 2022. Personat thellësisht të privuar materialisht janë ata që jetojnë në familje që nuk mund të përballojnë financiarisht të paktën katër nga nëntë kategoritë e privimit material të lidhura me asetet, kushtet e banimit apo aspektet financiare, si më poshtë:

- Vonesat në pagesat e kredisë ose të qerasë për banesën kryesore, shpenzimet për shërbimet bazë, blerjet me këste ose pagesa të tjera të kredive të marra;
- Pamundësia për të përballuar shpenzimet për pushimet vjetore një javë larg nga shtëpia;
- Pamundësia për të përballuar një vakt me mish, pule, peshk (ose ekuivalentin për vegjetarianët) një herë në dy ditë;
- Pamundësia për të përballuar një shpenzim të paparashikuar financiar me vlerën 000 lekë të reja;
- Pamundësia financiare për të përballuar një telefon (duke përfshirë telefonin celular);
- Pamundësia financiare për të pasur një TV me ngjyra;
- Pamundësia financiare për të pasur një makinë larëse;
- Pamundësia financiare për të pasur një makinë;
- Pamundësia financiare e familjes për mbajtjen e shtëpisë ngrohtë në mënyrë të përshtatshme.

3. Intensiteti i punësimit në familje.

Intensiteti shumë i ulët në punësim i referohet situatës së personave në familje ku asnjë nuk punon, ose punon shumë pak, që do të thotë se anëtarët e familjes në moshë pune punojnë vetëm 20% apo më pak se numri gjithsej i muajve që ata mund të punonin gjatë periudhës së referencës. Individët e grupmoshës 18-59 vjeç, të cilët jetojnë në familje me intensitet shumë të ulët në punësim në vitin 2022 sipas vlerësimeve përbëjnë 11,3 %.

Më poshtë janë treguesit e varfërisë të Publikuar nga EUROSTAT deri në 2022:

1. Personat në rrezik për të qënë të varfër ose të privuar nga jeta sociale në vitin 2022

Sipas Eurostat, ky indikator llogaritet si shumë e tre indikatorëve të mësipërm të varfërisë. Çdo individ llogaritet vetëm një herë nëse i përket dy ose tre kategorive në të njëjtën kohë. Në vitin 2022, **Shqipëria zë vendin e parë si ne rajon ashtu dhe në Europë, me rreth 44.5% e popullsisë në varfëri, të privuar nga jeta sociale ose me një intesitet të ulët punësimi.**

Viti	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Shqipëria	58.5	53.9	50.8	46.2	46.6	44.5
Mali i Zi	42.2	41.2	36.6	37.8	38.9	34.1
Maqedonia e Veriut	36.9	35.3	34.2	32.6	:	
Serbia	39.3	33.9	31.1	29.8	28.4	28.1
Bashkimi Evropian - 27 shtete (nga 2020)	22.4	21.7	21.1	21.6	21.7	21.6

Burimi: Eurostat

2. Fëmijët (nën 18 vjeç) në rrezik për të qënë të varfër ose të privuar nga jeta sociale në vitin 2021

Edhe për moshën më pak se 18 vjeç, Shqipëria ka **treguesit më të lartë të varfërisë me 50.1%**. Kjo është dhe një nga arsyt kryesore të migrimit të familjeve, duke qënë se mbi 50% e moshës nën 18 vjeç janë te varfër, privohen nga ato drejtat sociale ose punojnë shume pak.

Viti	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Shqipëria	62	57.7	53.9	51	50.1	n/a
Mali i Zi	49	48.5	43.9	45.8	45.5	40.4
Maqedonia e Veriut	44.1	42.2	38.6	39.7	n/a	n/a
Serbia	41	35.9	34.5	30.6	27.5	27.1
Bashkimi Evropian - 27 shtete (nga 2020)	25.1	23.9	22.8	24	24.4	24.7

Burimi: Eurostat

Ndryshimi i Popullsisë në Shqipëri 2014-2023

Një nga çështjet më të diskutuara sot është sa është popullsia aktuale e Shqipërisë – përgjigjen e së cilës mund ta japë vetëm një regjistrim popullsie i rregullt. Censusi i fundit është ai i vitit 2011 ku popullsia ishte afërsisht 2.9 milion banorë. Meqenëse Shqipëria është një vend me një zhvillim të shpejtë të demografisë si pasojë e emigrimit u la si rekomandim kryerja e një minicensusi në vitin 2015, i cili do të numëronte popullsinë pa u detajuar në të dhëna të tjera. Ky minicensus nuk u zhvillua.

Censusi i radhës, i planifikuar të kryhej në 2020, por i shtyrë për arsye të pandemisë, duhej të kryhej në vitin 2021, por u shty përsëri për arsye të zgjedhjeve. Ndërsa në vitin 2022 nuk u bë, dhe arsyeja që u dha nga INSTAT ishte se institucioni nuk arriti të bënte tenderin për blerjen e 8 mijë tabletave që do të përdreshin për kryerjen e censurit.

Në këndvështrimin tonë, duke krahasuar me historikun e kryerjes së këtij procesi në të kaluarën dhe në vendet fqinje, procesi i regjistrimit të popullsisë i vitit 2023 është kryer në mënyrë jo transparente, duke ngritur hije dyshimi për metodologjinë dhe saktësinë e tij dhe të shifrave që priten të bëhen publike. Ne dëshirojmë të theksojmë faktin se proceset që nuk janë transparente dhe me rezultate të gjithëpranuara, kanë efekte në shoqëri, dhe deformatojmë politikëbërjen efektive dhe të qëndrueshme në mënyrë afatgjatë.

Rezultatet e këtij censusi po dalin rreth 8 muaj më vonë, ndërkohë që në vende të tjera të rajonit që kanë përdorur të njëjtën metodologji me tableta rezultatet kanë dalë në një kohë më të shkurtër.

- Kosova e zhvilloi censusin nga data 4 prill deri në 24 maj 2024. Më datë 27 maj është publikuar popullsia residente si numër, ndërsa në datën 12 korrik 2024 do të publikohen të dhënat paraprake më të detajuara (një kohëzgjatje për 7 javësh).
- Serbia e zhvilloi censusin nga data 1 tetor deri 31 tetor 2022 dhe i publikoi të gjithë rezultatet brenda 7 javësh, më datë 21 dhjetor 2022.
- Mali i Zi e zhvilloi censusin nga data 3 në 30 dhjetor 2023 dhe i publikoi rezultatet paraprake me 25 janar 2024, pra në më pak se një muaj.

Nga ana tjetër, historia e kryerjes së këtij procesi në vendin tonë tregon se edhe me një mungesë të teknologjisë së përdorur këtë vit, periudha e publikimit ka qenë e njëjtë me atë të vendeve të rajonit. Kur u krye censusi në vitin 2011 të dhënat paraprake në nivel vendi dhe qarku kanë dalë **pas gjashtë javësh (censusi u krye në tetor 2011 dhe rezultatet dolën me 21 dhjetor 2011)** dhe atëherë teknologjia e përdorur ishte me pyetësorët e skanuar.

Ndërsa në vitin 2023, **të dhënat duhen të dilnin sa të përfundonte dhe pyetësori i fundit sepse janë përdorur tabletat dhe çdo pyetësor shkon direkt në databazë.**

Shqetësimi ynë si ekspertë dhe i APC është në pasojat afatmesme dhe afatgjata të publikimit të një shifre që do të shihet me dyshim dhe mund të jetë e pavërtetë. Nëse do të jetë ky rasti, mbi këtë shifër do bëhet çdo politikë ekonomike dhe sociale për dhjetëvjeçarin e ardhshëm. Do të jetë kjo shifër që do të merret në konsideratë nga institucione të huaja dhe të brendshme.

Ribërja e një censusi është e pamundur nisur nga kostot që ai ka. E vetmja zgjidhje që ne propozojmë është kryerja e një minicensusi për të ditur apo rikonfirmuar vetëm numrin e popullsisë.

Nga ana jonë, si Qendër kërkimore dhe politikash, ne i jemi referuar të dhënave të EUROSTAT, Institutit Europian të statistikave.

Të dhënat e detajuara të EUROSTAT dhe krahasimi me vendet e rajonit

Në bazë të dhënave të përditësuara nga EUROSTAT, shifrat për emigrimin në periudhën 2014-2023 janë si më poshtë:

1. Persona të larguar nga vendi në menyrë të rregullt (pajisur me letra) në total që nga 2014-2022 janë **478.245**. Në bazë të statistikave të Eurostat ne zëmë vendin e parë në Ballkan.

Shteti	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	Total
Bosnje Hercegovina	18.516	19.779	26.187	36.010	53.566	56.477	35.311	33.113	47.871	326.830
Mali i Zi	1.623	1.816	2.130	2.325	2.979	3.902	2.786	2.266	3.835	23.662
Maqedonia e Veriut	9.853	11.764	13.948	16.416	24.046	26.756	16.521	14.187	27.653	161.144
Serbia	24.367	26.603	30.572	39.654	51.022	62.417	41.096	44.096	69.426	389.253
Kosova	17.714	18.958	20.668	25.890	34.542	43.716	32.055	20.359	23.036	236.938
Shqipëria	32.456	49.059	57.199	48.585	59.197	62.055	38.192	54.981	76.521	478.245

Në tabelën e mëposhtme paraqiten dhe arsyet e largimeve:

Arsyeja	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	Total
Arsye familjare	19.533	28.686	33.283	27.226	31.856	28.928	19.493	32.640	42.091	263.736
Arsye edukimi	1.465	1.332	1.632	1.874	2.348	2.227	1.230	1.946	2.479	16.533
Arsye punësimi	3.211	2.217	4.138	5.569	9.873	12.654	5.847	11.703	20.213	75.425
Arsye të tjera	8.247	16.824	18.146	13.916	15.120	18.246	11.622	8.692	11.738	122.551
Totali										478.245

Sigurisht në vendin e parë janë largimet për arsye familjare por ajo që vihet re është që në veçanti pas viteve 2018 ka një largim të individëve të pajisur me letra pune. Dhe ky numër sa vjen dhe rritet.

Këto shifra në nivele të larta të largimit të shqiptarëve nga vendi verifikohen dhe nga të dhënat që vijnë nga regjistrimet e nxënësve dhe studentëve në nivelet e ndryshme të edukimit në vend. **Nga të dhënat e publikuara, ka një ulje të të gjithë niveleve të regjistrimeve por sidomos ne ciklin parauniversitar.**

Nese krahasojmë regjistrimet e vitit 2023-2024 me 11 vjet më parë kur popullsia ka qenë e sapo publikuar nga regjistrimi, ka një rënie drastike në të gjitha nivelet . Kjo vjen si pasojë e:

- Shpopullimit të vendit nga ikjet masive, pasi një pjesë e konsiderueshme e të larguarve janë së bashku me familjet e tyre e fëmijët sidomos nën moshën 18 vjeç.

ISCED-2011	Viti akademik	2012-13	2013-14	2014-15	2015-16	2016-17	2017-18	2018-19	2019-20	2020-21	2021-22	2022-23	2023-24	Δ%	Δ në vliere
	Të regjistruar në arsim														
	Gjithsej:	801,982	786,230	748,488	704,779	677,818	649,938	641,161	612,534	589,604	577,869	554,222	533,711	-33%	-268,271.0
2	Kopsht	81,865	81,448	82,494	82,623	81,194	81026	78,942	77,858	71,332	72,384	69,750	66,711	-19%	-15,154.0
	9 vjeçar:	390837	377074	363408	343499	328100	319771	306530	294879	286486	278138	267275	258072	-34%	-132,765.0
3	1 mesëm:	154,937	151,937	140,042	130,380	127,114	120062	116,646	109,533	107,989	103,467	95,845	91,755	-41%	-63,182.0
5-8	1 lartë	173,029	173,819	160,425	146,756	139,607	129179	139,043	130,264	123,797	123,880	121,352	116,994	-32%	-56,035.0

- Rënies së lindshmerisë, megjithëse kjo është e dukshme vetëm për kopshtet dhe arsimin e ciklit fillor, që kap moshën 3-6 vjeç.

Natyrisht, **lindshmëria në Shqipëri është në nivele tejet të ulëta, në nivelin 1.21, shumë më poshtë nivelit kufitar prej 2.1 që duhet të jetë**, i cilësuar si niveli i zëvendësimit, i cili siguron vazhdimësinë e një kombi. Por, rënia e fëmijëve apo studentëve të regjistruar në ciklet e ndryshme të edukimit nuk justifikohet dot vetëm nga rënia e lindshmërisë, pasi ajo i jep efektet pas gati një dekade.

- Më poshtë jepet numri i personave që kanë aplikuar për azil në vendet e BE-së. Edhe këtu përsëri në krahasim me Ballkanin, Shqipëria zë vendin e parë për aplikime me **191,670** persona që nga viti 2014-2023. Sipas të të dhënave bazuar në moshën, rreth 80% të azilantëve janë deri në moshën 34 vjeç. Pra, kërkon të largohet mosha më vitale për punë dhe të rinjtë që në të ardhmen do të shërbenin si forca kryesore në tregun e punës

Shteti	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Total
Bosnje Hercegovina	7.775	5.935	3.095	1.775	1.730	1.545	1.030	1.565	1.230	920	26.600
Mali i Zi	1.455	3.615	1.550	515	410	230	140	255	205	200	8.575
Maqedonia e Veriut	6.725	10.545	6.135	4.250	3.425	2.805	840	3.015	3.595	3.725	45.060
Shqipëria	14.175	64.150	27.265	20.415	17.225	17.065	4.990	8.840	10.650	6.895	191.670
Serbia	20.090	19.085	8.885	5.085	4.630	4.220	1.730	2.055	2.390	2.765	70.935
Kosova	34.090	66.860	9.140	5.290	3.250	2.825	1.515	1.600	2.450	2.305	129.325


3. Kategoria e tretë janë ato individë që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në vendet e BE.

Vendi	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	Total
Bosnje Hercegovina	3.780	3.335	3.385	3.930	3.695	4.140	3.595	4.005	4.810	34.675
Mali i Zi	785	725	530	780	775	840	925	985	1.085	7.430
Maqedonia e Veriut	4.145	4.790	4.025	6.150	5.560	6.570	6.270	6.190	6.705	50.405
Shqipëria	28.800	46.395	32.350	36.415	31.230	33.285	30.870	34.150	38.155	311.650
Serbia	14.675	12.830	10.200	13.905	12.310	12.955	16.355	14.090	13.165	120.485
Kosova	33.695	49.895	9.605	6.485	4.730	4.270	3.670	3.545	3.980	119.875

Ndërkohë, sipas të dhënave që vijnë nga Mbretëria e Bashkuar, situata është si më poshtë:

2. Numri i shqiptarëve që kanë shkuar në MB sipas tremujorëve, nga T1 i vitit 2018 deri T4 2022


Number of Albanian small boat arrivals, per quarter, Q1 2018 to Q1 2023



Source: Migration Observatory analysis of Home Office Immigration Statistics, Irr_D01;

3. Numri i azilantëve shqiptarë në Mbretërinë e Bashkuar në periudhën 2010-2022

Number of Albanian asylum applicants per year, UK, 2010 to 2022



Source: Home Office Immigration statistics, Asy_D01
 Notes: Comprises main applicants and family members ("dependants").



Propozime dhe konkluzione

Autorët e këtij raporti politikash, si pjesë e Albanian Policy Center, pas analizës së situatës së shpopullimit dhe të dhënave që vijnë nga institucionet e huaja, në konsultim me ekspertët e mbledhur në Tryezën Kombëtare për Shpopullimin paraqesin më poshtë disa propozime për grupet e interesit, politikëbërësit, dhe shoqërinë shqiptare.

- Ne besojmë se fenomeni i shpopullimit duhet të kthehet në emergjencë kombëtare dhe për këtë ne propozojmë një Pakt Kombëtar Patriotik të shoqërisë shqiptare, politikëbërjes dhe grupeve të interesit, që të tejkalojë ndasitë politike të përfshijë një strategji dhe plan afatgjatë tre der në pesë dekada për ta adresuar dhe për t'i dhënë fund kësaj plage të madhe të shqiptarëve.
- Ne propozojmë kryerjen e një census snap/shot të popullsisë reale të Shqipërisë në vitin 2025 në mënyrë që politikat e ardhshme 10-vjecare në ekonomi, arsim, shëndetësi dhe bujqësi të ndërtohen mbi një bazë të dhënash reale.
- Ne propozojmë një debat të hapur kombëtar për të vendosur disa politika për planifikim 30 dhe 50 vjecar të Shqipërisë, me pjesëmarrjen e Sociologëve, Antropologëve, Ekonomistëve, Demografëve, Planifikuesve të shëndetit pubik, Planifikuesve të Arsimit, Planifikuesve Urbanë dhe profesionistëve të tjera, duke pasur si synim rritjen e nivelit të lindshmërisë, rikthimin e trurit dhe rritjen e popullsisë përgjatë këtij shekulli.
- Politikat duhet të jenë të mirëmënduara, në funksion të rritjes së popullsisë dhe lindshmërisë, me një fokus në te liritë dhe të drejtat e patjetërsueshme të individit dhe te forcimi, mbrojtja e begatia e familjes shqiptare. Kjo arrihet me programe kombëtare dhe lehtësira fiskale për të mbështetur familjen shqiptare, gratë kryefamiljare, rininë dhe kthimin e të larguarve në atdhe nëpërmjet lehtësirave fiskale, mos-taksimit të start- upeve për një periudhë të caktuar kohe dhe paketave ekonomike që sigurojnë forcimin e individit dhe familjes.
- Ne propozojmë një sistem fiskal që lehtëson individin, duke e ndihmuar të çlirojë potencialin e vetë ekonomik, nëpërmjet taksimit të sheshtë, jo-progresiv, të ulët e proporcional, për sipërmarrjet apo personat fizikë që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë
- Ne theksojmë se parakusht për të ndaluar shpopullimin është liria e individit dhe garancia e një tregu të lirë, pa ndërhyrjen e shtetit dhe pa pengesa fiskale, duke i dhënë fund burokracisë.
- Ne inkurajojmë politikëbërësit të shkojnë drejt derregullimit dhe qeverisë së vogël, me një ndarje territoriale të drejtë që garanton decentralizim në cdo nivel, e duke mbrojtur të drejtat e përgjegjësitë e çdo niveli qeverisje, në rang bashkie, qarku apo qendror. Kjo duhet kryer së bashku me reduktimin në maksimum të ndërhyrjeve të shtetit në jetën ekonomike dhe të tregut në vend, duke evituar favorizimet e aktorëve të ndryshëm ekonomikë, e duke garantuar konkurrencë të lirë. Tregun e rregullon ndërveprimi individëve me njëri tjetrin, të lirië të kërkojnë e ofrojnë në treg, dhe të fitojnë ose humbin në bazë të meritokracisë.
- Duhet të përgatitet një reformë rrënjësore për rregullimin e pronës duke i dhënë fund arbitraritetit mbi pronën private dhe publike, dhe duke rishkuar disa ligje bazë të vendit në lidhje me pronën dhe sigurinë e pronës.
- Mungesa e sigurisë juridike është një nga shkaqet kryesore të largimit të njerëzve nga vendi. Ne propozojmë një rishikim të reformës në drejtësi dhe krijimin e mundësive të barabarta para ligjit duke filluar nga një rregullim i të gjithë shkallëve të gjyqësorit, për të rikthyer sigurinë juridike në vend, një nga shërbimet themelore që qytetarët kërkojnë.
- Duhet përgatitet një reformë e thellë dhe cilësore për arsimin para-universitar dhe universitar për të mundësuar mundësi të barabarta dhe edukim cilësor, patriotik e qytetar dhe kushte arsimore për nxënës dhe mësues në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke pasur një kujdes specifik për zonat e shpopulluara e ato rurale, duke rritur buxhetin për arsimin dhe duke futur metodat bashkëkohore dhe teknologjinë në arsim.
- Duhet përgatitet një reformë tërësore dhe cilësore në sistemin shëndetësor të vendit për të rritur cilësinë e shërbimit shëndetësor, besimin në sistem, cilësinë e dhënies së shërbimeve mjekësore, numrin e mjekëve të familjes, shërbimet të barabarta në të gjitha zonat e Shqipërisë, dhe rishikim të skemës së siguracioneve shëndetësore duke e thyer në sistem dixhital One-Health service. Ne të gjithë paguajmë për shëndetësinë dhe nuk marrim asnjë shërbim nga sistemi shëndetësor. Siguria shëndetësore duhet të jetë primare.
- Duhet politika punësimi dhe rishikim i sektorëve strategjik për motorrin e ekonomisë në vend, duke filluar nga industrializimi, bujqësia, turizmi dhe energjia si dhe shfrytëzimi i burimeve natyrore kombëtare. Duhet përgatitur politika për thithjen e investimeve të huaja të mëdha në vend, duke i dhënë fund praktikave korruptive

të ofertave të pakërkuara dhe PPP-ve korruptive, shfuqizimi i Ligjit për Investime Strategjike dhe Ligjit për Shpronësimet.

- Reforma e re territoriale dhe administrative duhet të bëhet në bazë të shifrave reale të popullsisë që janë rezident në Shqipëri, me fokus decentralizimin sipas modeleve më të mira perëndimore, duke krijuar qytete policentrike dhe duke ofruar shërbime në qendra të tjera jashtë qyteteve të mëdha.
- Mungesa e një sistemi zgjedhor të drejtë, që garanton zgjedhje të pavarura e të pandikuara ka çuar në një shkëputje të zgjedhësit me të zgjedhurin dhe një deformim të demokracisë përfaqësuese. Kjo ka bërë që qytetarët shqiptarë të humbasin besimin se vota e tyre vlen dhe mund të bëjë ndryshimin. Nevojitet një reformim i këtij sistemi që do të siguronte një përkthim të drejtë të vullnetit të shoqërisë në rezultatet zgjedhore, një rikthim të besimit në institucione dhe një rikthim të balancave të pushtetit.

Ne besojmë se duke adresuar pikat e mësipërme, duke ndryshuar sistemin ekonomik, social dhe politik, e duke zbatuar reformat e duhura, shoqëria shqiptare do të hedhë hapat e parë drejt rikthimit të besimit në institucione dhe drejt rikthimit të qindra mijëra shqiptarëve të larguar në këtë dekadë. Si Albanian Policy Center, u bëjmë një thirrje partive politike për të marrë parasysh rekomandimet tona dhe për të hapur një debat kombëtar për ndalimin e shpopullimit të Shqipërisë nga qytetarët e vetë.